



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:016554  
Datë: 18.10.2024  
Numri i dokumentit: 06320452

**Ca.nr.6166/2024**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Enes Mehmeti - kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Hidajete Gashi-Alaj, anëtar në çështjen juridike kontestimore të paditëses E.K, nga fshati Sopijë, Komuna e Suharekës, të cilën me autorizim e përfaqëson avokat Betim Kadolli nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, të cilën e përfaqëson Vlora Isufi Xhoxhaj, me objekt të padisë kompensimi i shujtave, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.144/2023 i datës 06.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **07.10.2024**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pa themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.144/2023 i datës 06.12.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.144/2023 i datës 06.12.2023, “pa shqyrtim kryesor të çështjes ka vendosur “... në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses E.K fshati Sopijë, Komuna e Suharekës, Detyrohet e paditura, Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, që paditëses E.K, nga fshati Sopijë, Komuna e Suharekës, në emër të shujtave ditore për 177 ditë pune për vitin 2021 (nga data 01.01.2021 deri me datë 31.12.2021), ti paguaj shumën e përgjithshme prej 354.00€ (treqind e pesëdhjetë e katër euro), me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 19.01.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha

*këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm. Në pikën II të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00€ (njëqind e njëzetë e katër euro), në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm....”*

Kundër këtij aktgjykimi, ka parashtruar ankesë e paditura përmes të autorizuarit për shkak të *shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar, të prish Aktgjykimin C.nr.144/2023 i datës 06.12.2023, të Gjykatës Themelore në Prizren–Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil dhe të hedhet poshtë padia e paditëses E.K apo; të ndryshoj aktgjykimin C.nr.144/2023 i datës 06.12.2023 të Gjykatës Themelore në Prizren–Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil ose aktgjykimi i ankimuar të prishet dhe çështja të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

I autorizuari i paditëses nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa është e **pa themeltë**.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësja, përmes të autorizuarit të saj, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi me datë 19.01.2023, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, për kompensim të ushqimit-shujtave për ditët e pranisë në punë. I autorizuari i paditëses përmes padisë ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune në institucionin arsimor “Luciano Motroni” në Prizren ka punuar dhe vazhdon të punon dhe për vitin 2021 ka gjithsej 177 ditë pune. Në vazhdim ka shtuar se paditëses i takon kompensimi për shujtat ditore për vitin 2021, nga 2 euro në ditë, për çdo ditë pune, sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për pagesën e shujtave pranë DKA-së, deri më tani nuk kanë marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditëses vullnetarisht, gjykatës i kanë propozuar gjykatës që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Nga ana tjetër e paditura, përmes përgjigjes në padi, e ka kontestuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses për të njëjtat arsye si në ankesë, duke propozuar refuzimin e të njëjtës.

Gjykata e shkallës së parë, në fazën e përgatitjes së lëndës për shqyrtim kryesor të çështjes, pas vlerësimit të deklarimeve të ndërgjyqësve dhe fakteve jokontestuese në mes tyre si dhe provave në shkresat e lëndës që kanë të bëjnë me çështjen konkrete juridike, pasi që janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 152, lidhur me nenin 398 të LPK-së, ka marrë aktgjykimin e goditur “pa shqyrtim kryesor të çështjes”, duke vendosur që kërkesëpadinë e

paditëses ta aprovoj në tërësi si të bazuar, e në shumën e gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë ka vendosur se duke ju referuar dispozitës së nenit 8 par.1 dhe nenit 245, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), e lidhur me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021. Vendimin mbi kamatën e ka mbështetur në nenin 382 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e ka bazuar në nenin 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se, përfundimi logjik dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar në ligj, dhe se aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me kurrfarë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e as atyre nga neni 182.2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, për të cilat kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Aktgjykimi i goditur, në këtë kontest është i qartë dhe i kuptueshëm si në pjesën e arsytimit ashtu edhe në dispozitiv, ku figuron e qartë dhe e kuptueshme mënyra e vendosjes. Dispozitivi është edhe i ekzekutueshëm. E drejta materiale, për të cilën gjykata e shkallës së dytë kujdeset edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, është zbatuar në mënyrë të drejtë, gjë që ka rezultuar me miratimin e drejtë të kërkesëpadisë së paditëses në shumën e gjykuar, e që ky aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes është marrë drejtë nga gjykata e shkallës së parë pasi që janë plotësuar kushtet e parapara ligjore për marrjen e të njëjtit sipas nenit 398, të LPK-së, dhe nenit 452 të LPK-së prandaj i njëjti vërtetohet në tërësinë e tij.

Gjykata e Apelit, për arsyet e paraqitura si më lart, në pajtim me nenin 195 par. 1 pika d) e LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ca.nr.6166/2024 me datë 07.10.2024**

**Kryetari i kolegjit - gjyqtari**  
**Enes Mehmeti**